

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “ HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

STUDIMET POSTDIPLOMIKE – MASTER

DREJTIMI NDËRKOMBËTAR



PUNIM MASTERI

**E ardhmja e misioneve paqeruajtëse: Analizë krahasuese e Rezolutës 377 A
“Të bashkuar për paqe” (The Uniting for Peace Resolution) dhe “Brahimi
Report”**

Mentore:

Prof.Dr Remzije Istrefi

Kandidatja:

Rritë Konjuhi

Prishtinë, 2023

Abstrakt

Duke parë rolin dhe rëndësinë që kanë misionet ndërkombëtare sot në arenën ndërkombëtare, është më se e domosdoshme që të trajtohet koncepti i misioneve paqeruajtëse si mekanizëm thelbësor i organizatave ndërkombëtare. Një mënyrë e mirë për t'a zbërthyer konceptin e paqeruajtjes ndërkombëtare do të ishte analiza e dy dokumenteve që u krijuan për këtë qëllim, e të cilat janë Rezoluta 377 (V), e njohur si Rezoluta "Të Bashkuar për Paqe" dhe "Rishikimi gjithëpërfshirës i operacioneve paqeruajtëse në të gjitha aspektet e tyre", i njohur si "Brahimi Report". Çasja e tyre ndaj ruajtjes së paqes ndërkombëtare, mekanizmat që kanë paraparë për t'a arritur sigurimin e paqes në botë, pikat e përbashkëta të cilat i përfshijnë këto dy dokumente, dallimet mes njërit nga tjetri, efekti i tyre e poashtu duke analizuar edhe suksesin e arritur deri më tani si dhe sfidat më të cilat janë përballur, do të pasqyronin konceptin e paqes ndërkombëtare ku në këtë mënyrë do të mundësohej edhe avancimi i mëtutjeshëm i mekanizmave për sigurimin e saj në të ardhmen. Pikërisht për këtë arsye kam përzgjedhur këtë temë pasi e shoh të dobishme për secilin lexues që të jetë i informuar detajisht në këtë fushë e sidomos në këto dy dokumente të cilat janë të njohura për rëndësinë apo ndikimin që kanë sa i përket sigurimit të paqes botërore përmes misioneve ndërkombëtare paqeruajtëse.